



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.58 dt.24.04.1998

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.24.04.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Tregëtisë në përbërje të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik “Mbi disa investime në sektorin e tregut”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”,

VENDOSI

1. Diferenca prej 5.5 milion lekë e mbetur pa përdorur nga fondi i aprovuar prej 15 milion lekë (vendimi Nr.163, dt.29.09.19997) për ndërtimin e tregut elektroshtëpiak pas prokurimit të këtij fondi, të kalojë për objektet e poshtëshënuara :
 1. Tregu fruta perime tek rruga “4 Dëshmorët” 2.5 milion lekë.
 2. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës për tek tregu elektroshtëpiak 3 milion lekë.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI